

**MARRËVESHJA**  
**NDËRMJET**  
**REPUBLIKËS SË AUSTRISË**  
**DHE**  
**REPUBLIKËS SË KOSOVËS**  
**PËR ELIMINIMIN E TATIMIT TË DYFISHTË TË TATIMEVE NË TË ARDHURA**  
**DHE PARANDALIMIN E EVAZIONIT DHE SHMANGIES FISKALE**

Republika e Austrisë dhe Republika e Kosovës,

Duke dëshiruar të zhvillojnë më tej marrëdhëniet e tyre ekonomike dhe të rritin bashkëpunimin e tyre në çështjet e tatimeve.

Me qëllim për të lidhur një Marrëveshje për eliminimin e tatimit të dyfishtë të tatimeve mbi të ardhurat, pa krijuar mundësi për mos-tatim apo tatim të reduktuar nëpërmjet evazionit apo shmangies tatimore (duke i përfshirë marrëveshjet përmes ‘treaty-shopping’ që kanë për qëllim sigurimin e lehtësirave të parashikuara në këtë Marrëveshje për përfitimet e tërthorta të rezidentëve të shteteve të treta)

janë pajtuar si në vijim:

**Neni 1****PERSONAT E PËRFSHIRË**

Kjo Marrëveshje zbatohet për personat të cilët janë rezidentë të një ose të dy shteteve kontraktuese.

**Neni 2****TATIMET E PËRFSHIRA**

- (1) Kjo marrëveshje vlen për tatimet mbi të hyrat e ngarkuara në emër të një shteti kontraktues ose autoriteteve të tija politike apo lokale, pavarësisht mënyrës së inkasimit.
- (2) Me tatimet mbi të hyrat nënkuptohen të gjitha tatimet që grumbullohen nga të hyrat e përgjithshme ose të pjesshme, përfshirë edhe tatimin në fitim si rrjedhojë e tjetërsimit të pasurisë së luajtshme ose të paluajtshme, tatimin mbi pagën si dhe tatimin mbi vlerësimin e kapitalit.
- (3) Tatimet ekzistuese ndaj të cilave zbatohet marrëveshja janë në veçanti:
  - a) në Austri:
    - i. tatimi mbi të ardhurat;
    - ii. tatimi mbi të ardhurat e korporatave;  
(Në vijim do t'i referohemi si "tatimi në Austri")
  - b) në Kosovë:
    - i. tatimi mbi të ardhurat personale;
    - ii. tatimi mbi të ardhurat e korporatave.  
(Në vijim do t'i referohemi si "tatimi në Kosovë").
- (4) Marrëveshja do të zbatohet gjithashtu ndaj çdo tatimi të njëjtë ose thelbësisht të ngjashme të cilat janë vendosur pas datës së hyrjes në fuqi të marrëveshjes, si shtesë apo në vend të tatimeve ekzistuese. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese do të njoftojnë njëri-tjetrin për çdo ndryshim të rëndësishëm që është bërë në ligjet e tyre tatimore.

**Neni 3****PËRKUFIZIME TË PËRGJITHSHME**

- (1) Për qëllimet e kësaj Marrëveshje, nëse konteksti nuk e kërkon ndryshe,
- a) termi “Austri” nënkupton Republikën e Austrisë;
  - b) termi “Kosovë” nënkupton Republikën e Kosovës, përfshirë të gjithë territorin tokësor, mbi të cilin ajo ka juridiksion ose të drejta sovrane me qëllim të eksplorimit, shfrytëzimit dhe ruajtjen e burimeve natyrore në pajtim me të drejtën ndërkombëtare;
  - c) termat "shteti (kontraktues)" dhe "shteti tjetër (kontraktues)" nënkuptojnë Austrinë apo Kosovën varësisht nga kuptimi;
  - d) termi “person” përfshin një individ, një kompani dhe çdo organ tjetër personash;
  - e) termi “kompani” nënkupton çdo organ korporativ ose çdo entitet që trajtohet si organ korporativ për qëllime tatimore;
  - f) termi "ndërmarrje" nënkupton ushtrimin e çfarëdo lloj veprimtarie;
  - g) termi “ndërmarrje e një Shteti Kontraktues” dhe “ndërmarrje e Shtetit tjetër Kontraktues” nënkupton respektivisht një ndërmarrje e drejtuar nga një rezident i një Shteti Kontraktues dhe një ndërmarrje e drejtuar nga një rezident i Shtetit tjetër Kontraktues;
  - h) termi “trafik ndërkombëtarë” nënkupton çdo transport me anije ose aeroplan, që drejtohet nga një ndërmarrje që ka vendin e vet të menaxhimit efektiv në një Shtet Kontraktues, përveç kur anija ose avioni vepron vetëm ndërmjet vendeve në Shtetin tjetër Kontraktues;
  - i) termi “autoritet kompetent” nënkupton
    - i) në rastin e Austrisë: Ministrin Federal të Financave ose përfaqësuesin e tij/saj të autorizuar;
    - ii) në rastin e Kosovës: Ministri i Financave ose përfaqësuesi i tij/i saj i autorizuar;
  - j) termi "shtetas" në lidhje me një Shtet Kontraktues nënkupton:
    - i) çdo individ që zotëron nënshtetësinë ose shtetësinë të atij Shteti Kontraktues; dhe
    - ii) çdo person juridik, ortakëri ose shoqatë që gëzon statusin si të tillë nga ligjet në fuqi në një Shtet Kontraktues;

k)Termi „aktivitet biznesor“ ngërthen në vete ushtrimin e aktiviteteve profesionale dhe aktiviteteve të tjera me karakter të pavarur.

- (2) Sa i përket zbatimit të Marrëveshjes në çdo kohë nga një Shtet Kontraktues, çdo term i pa përcaktuar këtu, përveç kur konteksti e kërkon ndryshe, ka kuptimin që ka pasur në atë kohë sipas ligjit të atij Shteti për qëllimet e tatimeve për të cilat zbatohet Marrëveshja, çdo kuptim sipas ligjeve të zbatueshme tatimore të atij Shteti mbizotëron mbi kuptimin që i jepet termi në ligje të tjera të atij Shteti.

#### Neni 4

#### **REZIDENTI**

- (1) Për qëllime të kësaj Marrëveshje, termi “rezident i një Shteti Kontraktues” nënkupton çdo person, i cili sipas ligjeve të atij Shteti u nënshtrohet tatimeve përkatëse për shkak të vendbanimit, rezidencës, vendit të menaxhimit, ose çdo kriteri tjetër të një natyre të ngjashme dhe gjithashtu përfshin atë shtet dhe çdo nënndarje politike apo autoritet lokal atje. Megjithatë, ky term nuk përfshin asnjë person që i nënshtrohet tatimit në atë Shtet në lidhje me të ardhurat nga burimet në atë shtet.
- (2) Kur për shkak të dispozitave të paragrafit 1, një individ është rezident në të dyja Shtetet Kontraktuese, atëherë statusi i tij do të përcaktohet si vijon:
- a) Personi do të konsiderohet rezident vetëm në atë Shtet, në të cilin ka një vendbanim të përhershëm në shfrytëzim të tij; nëse ai ka një vendbanim të përhershëm në shfrytëzim të tij në të dyja shtetet Kontraktuese, ai konsiderohet të jetë rezident vetëm i Shtetit me të cilin interesat e tij personale dhe ekonomike janë të lidhura më ngushtë (qendra e interesave jetike);
  - b) nëse Shteti në të cilin ai ka qendrën e interesave të tij jetike nuk mund të përcaktohet ose nëse nuk ka një vendbanim të përhershëm në shfrytëzim të tij në asnjë shtet Kontraktues, ai do të konsiderohet të jetë rezident vetëm i Shtetit në të cilin qëndron zakonisht;
  - c) nëse ai qëndron zakonisht në të dyja shtetet ose në asnjërin prej tyre, ai do të konsiderohet të jetë rezident vetëm i Shtetit, shtetas i të cilit është;
  - d) nëse ai është shtetas i të dy shteteve ose i asnjërit prej tyre, autoritetet kompetente të shteteve Kontraktuese do të zgjidhin çështjen me anë të marrëveshjes reciproke.
- (3) Kur për shkak të dispozitave të paragrafit 1, një person përveç individit, është rezident i të dyja shteteve Kontraktuese, atëherë ai do të konsiderohet rezident vetëm i Shtetit në të cilin ndodhet vendi i menaxhimit efektiv.

**Neni 5****NJËSIA E PËRHERSHME**

- (1) Për qëllimet e kësaj marrëveshjeje, termi “njësi e përhershme” nënkupton një vend fiks biznesi, nëpërmjet të cilit ushtrohet tërësisht ose pjesërisht biznesi i një ndërmarrjeje.
- (2) Termi “njësi e përhershme” përfshin, në veçanti:
- a) një vend menaxhimi,
  - b) një degë,
  - c) një zyrë,
  - d) një fabrikë,
  - e) një punishte dhe
  - f) një minierë, një pus naftë ose gazi, një gurore ose një vend tjetër i nxjerrjes së burimeve natyrore.
- (3) Termi “njësi e përhershme” po ashtu përfshinë:
- a) një vend ndërtimi, një projekt ndërtimi, montimi ose aktivitete lidhur me punën e monitorimit, por vetëm nëse ato zgjasin më shumë se dymbëdhjetë muaj.
  - b) ofrimi i shërbimeve, duke përfshirë shërbimet e konsulencës, nga një ndërmarrje nëpërmjet punonjësve ose personelit tjetër të angazhuar nga ndërmarrja për këtë qëllim, por vetëm nëse aktivitetet e asaj natyre vazhdojnë (për të njëjtin ose një projekt të lidhur) brenda një Shteti Kontraktues për një periudhë në total me më shumë se 183 ditë në çdo periudhë 12-mujore që fillon ose përfundon në vitin përkatës fiskal.
- (4) Pavarësisht nga dispozitat e mësipërme të këtij Neni, me “njësi të përhershme” nuk nënkupton:
- a) përdorimin e ambienteve vetëm për qëllime magazinimi, ekspozimi ose shpërndarjeje të lëndës së parë dhe produkteve finale të ndërmarrjes;
  - b) mbajtjen në stok të lëndës së parë dhe produkteve finale të ndërmarrjes, vetëm për qëllime magazinimi, ekspozimi ose shpërndarjeje;
  - c) mbajtjen në stok të lëndës së parë ose produkteve finale të ndërmarrjes, vetëm për qëllime të përpunimit dhe finalizimit të produktit nga një ndërmarrje tjetër;
  - d) Objektin fizik të ndërmarrjes i cili si aktivitet biznesor të vetëm ka blerjen e lëndës së parë apo produkteve finale, ose të mbledhjes së informacioneve për ndërmarrjen;

- e) Objektin fizik të ndërmarrjes i cili si detyrë të vetme ka kryerjen e aktiviteteve të tjera për ndërmarrjen;
- f) Objektin fizik të ndërmarrjes i cili si detyrë të vetme ka kryerjen e disa aktiviteteve të përmendura në paragrafët a) deri në e),

me kusht që një veprimtari e tillë ose, në rastin të paragrafit f), veprimtaria e përgjithshme e objektit fizik të ndërmarrjes, është me karakter përgatitor ose ndihmës.

- (5) Pavarësisht nga dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2, kur një person, i ndryshëm nga një agjent me status të pavarur për të cilin zbatohet paragrafi 6, vepron në emër të një ndërmarrjeje dhe ka në shtetin Kontraktues autorizim për të lidhur kontrata në emër të ndërmarrjes dhe zakonisht vepron me atë autorizim, ajo ndërmarrje konsiderohet të ketë një njësi të përhershme në atë shtet për çdo aktivitet që ai person ndërmerr për ndërmarrjen, përveç kur aktivitetet e atij personi janë të kufizuara në ato që përmenden në paragrafin 4, të cilat, nëse ushtrohen nëpërmjet një objekti fizik të ndërmarrjes, nuk do ta bënin këtë objekt fizik të ndërmarrjes njësi të përhershme sipas dispozitave të atij paragrafi.
- (6) Një ndërmarrje e një Shteti Kontraktues nuk konsiderohet të ketë njësi të përhershme në një Shtet Kontraktues vetëm ngaqë zhvillon biznesin në atë shtet nëpërmjet një ndërmjetësi, agjenti komisionar të përgjithshëm ose çdo agjenti tjetër me status të pavarur, me kusht që ata persona të veprojnë në rrjedhën e zakonshme të biznesit të tyre.
- (7) Fakti që një kompani, e cila është rezidente e një Shteti Kontraktues kontrollon ose kontrollohet nga një kompani, e cila është rezidente e Shtetit tjetër Kontraktues ose që zhvillon biznes në atë shtet tjetër (qoftë nëpërmjet një njësie të përhershme ose ndryshe), nuk përbën në vetvete arsye të mjaftueshme për ta konsideruar një të kompani njësi të përhershme të kompanisë tjetër.

## Neni 6

### **TË ARDHURAT NGA PASURIA E PALUAJTSHME**

- (1) Të ardhurat që realizohen nga një rezident i një Shteti Kontraktues nga pasuritë e paluajtshme (duke përfshirë të ardhurat nga bujqësia ose pylltaria), që gjenden në Shtetin tjetër Kontraktues, mund të taten në atë shtet tjetër Kontraktues.
- (2) Termi “pasuri e paluajtshme” do të ketë kuptimin sipas ligjit të Shtetit Kontraktues në të cilin ndodhet pasuria në fjalë. Në çdo rast, termi do të përfshijë pajisjet ndihmëse të pasurisë së paluajtshme, bagëtinë dhe inventarin fizik të ndërmarrjeve agro-ekonomike dhe pylltarisë, të drejtat për të cilat zbatohen dispozitat e legjislacionit të përgjithshëm në lidhje me tokën, e drejta e përdorimit të pasurisë së paluajtshme dhe të drejtat për pagesa të ndryshueshme ose fikse për shfrytëzim, ose të drejtën për shfrytëzimin e burimeve minerale, burimeve dhe pasuritë e tjera natyrore; anijet dhe aeroplanët nuk konsiderohen si pasuri të paluajtshme.
- (3) Dispozitat e paragrafit 1 zbatohen për të ardhurat që rrjedhin nga përdorimi i drejtpërdrejtë, dhënia me qira ose dhënia në shfrytëzim, si dhe përdorimi i çdo forme tjetër të pasurisë së paluajtshme.
- (4) Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 3 do të zbatohen, gjithashtu, për të ardhurat nga pasuria e paluajtshme e një ndërmarrjeje.

## Neni 7

### **FITIMET NGA BIZNESI**

- (1) Fitimet e një ndërmarrjeje të një Shteti Kontraktues do të taten vetëm në atë shtet, përveç kur ndërmarrja zhvillon biznes në Shtetin tjetër Kontraktues nëpërmjet një njësie të përhershme të vendosur atje. Nëse ndërmarrja zhvillon biznes si më sipër, fitimet e ndërmarrjes mund të taten në shtetin tjetër por vetëm në shumën sa i takon asaj njësie të përhershme.
- (2) , kur një ndërmarrje e një Shteti Kontraktues ushtron biznes në Shtetin tjetër Kontraktues nëpërmjet një njësie të përhershme të vendosur aty, atëherë varësisht prej dispozitave të paragrafit 3 fitimet të cilat mund të priten të realizohen duhen t'i atribuohen njësisë së përhershme në çdo shtet kontraktues, sikur të ishte një ndërmarrje e pavarur duke ushtruar biznes të nejtë ose të përafërt në rrethana të njejta apo të përafërta dhe në raport me ndërmarrjen, njësi e së cilës është, do të ishte plotësisht e pavarur.
- (3) Në përcaktimin e fitimeve të një njësie të përhershme, shpenzimet të cilat janë shkaktuar do të lejohen si zbritje për qëllimet e njësisë së përhershme, duke përfshirë shpenzimet ekzekutive dhe të përgjithshme administrative, të bëra qoftë në shtetin ku ndodhet njësia e përhershme ose gjetiu.

- (4) Për aq sa është e zakonshme në një shtet kontraktues të përcaktoj fitimet që i atribuohen një njësie të përhershme mbi bazën e ndarjes së fitimeve totale të ndërmarrjes në pjesët e saj të ndryshme, paragrafi 2 nuk e përjashton që ky shtet kontraktues të përcaktoj fitimin që duhet tatur sipas ndarjes së zakonshme; mënyra e ndarjes së fitimit duhet të jetë e tillë, që rezultati të jetë në harmoni me parimet e këtij neni.
- (5) Vetëm për mes blerjes së lëndës së parë apo produkteve finale për ndërmarrjen nuk i atribohet asnjë fitim njësisë të përhershme.
- (6) Duke aplikuar paragrafët e lartpërmendura, fitimet që i atribohen njësisë së përhershme, duhet të llogariten në të njëjtën mënyrë çdo vit, vetëm nëse ka arsye të mjaftueshme për të vepruar ndryshe.
- (7) Në rast se fitimet krijohen nga të ardhura të cilat trajtohen ndaras në nene tjera të kësaj marrëveshje, atëherë dispozitat e këtyre neneve nuk do të ndikohen nga dispozitat e këtij neni.
- (8) Ky nen zbatohet gjithashtu për të ardhurat e krijuara nga një rezident i një shteti kontraktues për ushtrimin e aktiviteteve profesionale dhe aktiviteteve të tjera me karakter të pavarur. Termi "punë e pavarur" përfshin aktivitete të pavarura shkencore, letrare, artistike, edukative ose mësimore, si dhe aktivitete të pavarura të mjekëve, avokatëve, inxhinierëve, arkitektëve, dentistëve dhe kontabilistëve.

## Neni 8

### TRANSPORTI UJOR DHE AJROR

- (1) Fitimet nga veprimtaria e transportit ujor dhe ajror në trafikun ndërkombëtar do të jenë të tatueshme vetëm në shtetin kontraktues ku është i vendosur vendi i menaxhimit efektiv i ndërmarrjes.
- (2) Nëse vendi i menaxhimit efektiv i një ndërmarrjeje të transportit ujor është në bordin e një anijeje, atëherë ai do të konsiderohet i vendosur në shtetin kontraktues në të cilin ndodhet porti i anijes, ose, nëse nuk ka një port të tillë vendas në shtetin kontraktues, atëherë vlen shteti kontraktues në të cilin është rezident personi i cili operon me anijen.
- (3) Dispozitat e paragrafit 1 do të zbatohen gjithashtu për fitimet nga pjesëmarrja në një fond grupor- (pool), një biznes i përbashkët apo një njësie të përhershme ndërkombëtare.

**Neni 9****NDËRMARRJET E LIDHURA****(1) Kur**

- a) një ndërmarrje e një shteti kontraktues merr pjesë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose në mënyrë të tërthortë në menaxhimin, kontrollin ose kapitalin e një ndërmarrjeje të shtetit tjetër kontraktues ose
  
- b) të njëjtët persona marrin pjesë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose në mënyrë të tërthortë në menaxhimin, kontrollin ose kapitalin e një ndërmarrjeje të një shteti kontraktues dhe një ndërmarrjeje të shtetit tjetër kontraktues

dhe kur në të dyja rastet, të dy ndërmarrjet kanë vendosur kushte obligative në raport me marrëdhëniet e tyre tregtare ose financiare, të cilat ndryshojnë nga ato që do të vendoseshin ndërmjet ndërmarrjeve të pavarura, fitimet që një ndërmarrje do të krijonte pa këto kushte, por e cila nuk i ka krijuar për shkak të këtyre kushteve, atëherë këto do ti atribuohen fitimeve të kësaj ndërmarrjeje dhe rrjedhimisht taten në përputhje me rrethanat.

- (2) Kur një shtet kontraktues përfshin në fitimet e një ndërmarrjeje të atij shteti - dhe i taton rrjedhimisht - fitimet për të cilat një ndërmarrje e shtetit tjetër kontraktues është tatuar në atë shtet tjetër dhe fitimet e përfshira në këtë mënyrë janë fitime të cilat do t'i ishin shtuar ndërmarrjes së shtetit të përmendur në fillim, nëse kushtet e vendosura midis dy ndërmarrjeve do të kishin qenë ato që do të ishin vendosur midis ndërmarrjeve të pavarura, atëherë shteti tjetër do të bëjë një rregullim të përshtatshëm ndaj shumës së tatimeve të vendosura në shumën e tatimit të ngarkuar mbi ato fitime. Në përcaktimin e këtij rregullimi do ti kushtohet vëmendje dispozitave të tjera të kësaj marrëveshjeje dhe autoritetet kompetente të shteteve Kontraktuese, sipas rastit, do të konsultohen me njëri-tjetrin.

## Neni 10

### DIVIDENDËT

- (1) Dividendët që një kompani që është rezidente një shteti kontraktues i paguan një personi i cili është rezident i një shteti tjetër kontraktues, atëherë ato mund të taten në shtetin tjetër.
- (2) a) Megjithatë, këto dividenda mund të taten gjithashtu në shtetin kontraktues, ku kompania paguese e dividendëve është rezidente dhe në përputhje me ligjet e këtij shteti, por nëse përfituesi ligjor i dividendëve është rezident i shtetit tjetër kontraktues, tatimi i ngarkuar nuk do të tejkalojë 15 përqind të shumës bruto të dividendëve.
  - b) Nëse përfituesi ligjor është një kompani (por jo një ortakëri) që posedon të paktën 25 përqind të kapitalit të kompanisë që paguan dividendët, atëherë këto dividendë mund të taten vetëm në shtetin kontraktues, në të cilin përfituesi ligjor i dividendëve është rezident.

Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese do të vendosin me marrëveshje reciproke mënyrën e aplikimit të kufizimeve. Ky paragraf nuk do të ndikojë në tatimin e kompanisë në lidhje me fitimet nga të cilat paguhen dividendët.

- (3) Termi "dividendë", siç përdoret në këtë nen nënkupton të ardhurat nga aksionet, letrat me vlerë aksionet e minierave, aksionet e themeluesve ose të drejta të tjera, që nuk janë kërkesa, me pjesëmarrje në fitim, si dhe të ardhura që i nënshtrohen të njëjtit trajtim tatimor si të ardhurat nga aksionet sipas ligjeve të shtetit ku kompania që bën shpërndarjen e të ardhurave është rezidente.
- (4) Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 nuk do të zbatohen nëse përfituesi ligjor i dividendëve, duke qenë rezident i një shteti kontraktues, ushtron biznes në shtetin tjetër kontraktues, për të cilin kompania paguese e dividendëve është rezidente nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur aty dhe ndërmarrjes aksionare për të cilën paguhen dividendët është efektivisht e lidhur me këtë seli të përhershme. Në këtë rast zbatohen dispozitat e nenit 7.
- (5) Kur një kompani që është rezidente e një shteti kontraktues realizon fitime ose të ardhura nga shteti tjetër kontraktues, shteti tjetër nuk mund të vendosë ndonjë tatim mbi dividendët e paguar nga kompania, përveç nëse këto dividendë i paguhen një personi rezident i një shteti tjetër ose pjesa për të cilën janë paguar dividendët i takon me të vërtet një njësi të përhershme rezidente në një shtet tjetër, si dhe nuk mund Shteti tjetër as nuk mund të tatojë fitimet e pashpërndara të kompanisë, edhe nëse dividendët e paguara ose fitimet e pashpërndara përbëhen tërësisht ose pjesërisht nga fitime ose të ardhura të realizuara në shtetin tjetër.

**Neni 11****INTERESI**

- (1) Interesi që krijohet në një shtet kontraktues dhe i paguhet një rezidenti të shtetit tjetër kontraktues mund të tatohet vetëm në atë shtet tjetër.
- (2) Megjithatë, ky interes që krijohet në një shtet kontraktues mund të tatohet në shtetin kontraktues ku ato krijohen dhe në përputhje me ligin e atij shteti, por nëse përfituesi ligjor i interesit është rezident i shtetit tjetër kontraktues, tatimi i ngarkuar nuk do të kalojë 10 përqind të shumës bruto të interesit. Autoritetet kompetente të shteteve kontraktuese do të vendosin me marrëveshje të përbashkët mënyrën e zbatimit të këtij kufizimi.
- (3) Termi "interes" në kuptimin e përdorur në këtë nen nënkupton të ardhurat nga kërkesat e borxhit të çdo lloji, edhe nëse kërkesat janë siguruar nga hipoteka e tokave, ose me pjesëmarrje në fitimin e debitorit, dhe në veçanti të ardhurat nga letrat shtetërore me vlerë dhe të ardhurat nga obligimet , përfshirë primet dhe shpërblimet që rrjedhin nga fitimet nga dëftesat e borxhit.  
Gjobat për pagesa të vonuara nuk konsiderohen si interes në kuptim të këtij neni.
- (4) Dispozitat e paragrafit 1 dhe 2 nuk zbatohen nëse përfituesi ligjor është rezident i një shteti kontraktues dhe përmes një njësie të përhershme ushtron biznes në shtetin tjetër kontraktues , nga i cili rrjedh interesi, dhe borxhi për të cilin duhet paguar interesi i përkasin më të vërtet kësaj njësie të përhershme. Në këtë rast, zbatohen dispozitat e nenit 7.
- (5) Interesi konsiderohet se është krijuar në një Shtet Kontraktues kur debitori është rezident i atij shteti. Megjithatë, kur debitori i interesit , qoftë ai rezident i një shteti kontraktues apo jo, ka në një shtet kontraktues një njësi të përhershme, e cila ka krijuar borxh për të cilën paguhet interesi, dhe ky interes krijohet nga kjo njësi e përhershme ose një objekt fizik dhe po e njëjta e mbulon interesin, atëherë ky interes do të konsiderohet se është krijuar në shtetin në të cilin ndodhet njësia e përhershme.
- (6) Në rast se në mes debitorit dhe përfituesit ligjor ose në mes secilit prej tyre dhe një pale të tretë ekzistojnë marrëdhënie të veçanta dhe për këtë arsye interesi tejkalon shumën, krahasuar me borxhin themelor, për të cilin debitori dhe përfituesi ligjor do ishin pajtuar pa këto marrëdhënie, atëherë ky nen do të zbatohet vetëm për shumën e fundit. , Në këtë rast, pjesa e tepërt e shumës mund të tatohet sipas ligjeve të secilit shtet kontraktues, duke pasur parasysh dispozitat tjera të kësaj Marrëveshje.

## Neni 12

### TANTIEMAT

- (1) Tantiemat që rezultojnë nga një shtet kontraktues dhe përfituesi i tyre ligjor është Person rezident në një shtet tjetër kontraktues mund të taten vetëm në shtetin tjetër.
- (2) Termi "tantiemat" siç përdoret në këtë Nen nënkupton pagesat e çdo lloji të pranuar si shpërblim për përdorimin ose, të drejtën e përdorimit të çdo të drejte autoriale për punime letrare, punë artistike ose shkencore, përfshirë filmat kinematografik, çdo patentë, markë tregtare, skicë ose model, plan, proces ose formulë sekrete, ose për informacione lidhur me eksperiencën industriale, tregtare apo shkencore.
- (3) (Dispozitat e paragrafit 1 nuk do të zbatohen nëse përfitues ligjor si rezident i një Shteti Kontraktues dhe përmes një njësie të përhershme ushtron biznes në Shtetin tjetër Kontraktues, nga i cili rezultojnë tantiemat dhe të drejtat dhe asetet financiare për të cilat paguhen tantiema i takojnë me të vërtetë kësaj njësie të përhershme. Në këtë rast do të zbatohen dispozitat e nenit 7.
- (4) Në rast se në mes debitorit dhe përfituesit ligjor ose në mes secilit prej tyre dhe një pale të tretë ekzistojnë marrëdhënie të veçanta dhe për këtë arsye tantiemat tejkalon shumën, krahasuar me shërbimin themelor, për të cilin debitori dhe përfituesi ligjor do ishin pajtuar pa këto marrëdhënie, atëherë ky nen do të zbatohet vetëm për shumën e fundit. Në këtë rast, pjesa e tepërt e shumës mund të taten sipas ligjeve të secilit shtet kontraktues, duke pas parasysh dispozitat tjera të kësaj marrëveshjeje.

## Neni 13

### FITIMET NGA TJETËRSIMI I KAPITALIT

- (1) Fitimet e realizuara nga një rezident i një Shteti Kontraktues nga tjetërsimi i pasurisë së paluajtshme të përmendura në nenin 6 dhe të vendosura në Shtetin tjetër Kontraktues, mund të taten në atë Shtet tjetër.
- (2) Fitimet nga tjetërsimi i pasurive të luajtshme, që janë pjesë e pronës e një njësie të përhershme, dhe që një ndërmarrje e një Shteti Kontraktues ka në Shtetin tjetër Kontraktues, përfshirë edhe fitimet nga tjetërsimi i kësaj njësie të përhershme (si e vetme ose ndërmarrje e tërë), mund të taten në atë Shtet tjetër.
- (3) Fitimet e realizuara nga tjetërsimi i anijeve ose avionëve që veprojnë në trafikun ndërkombëtar dhe i pasurive të luajtshme që i përkasin veprimtarisë së këtyre anijeve apo avionëve mund të taten vetëm në Shtetin Kontraktues në të cilin ndodhet vendi i menaxhimit efektiv i ndërmarrjes.

- (4) Fitimet e realizuara nga një rezident i një Shteti Kontraktues nga tjetërsimi i aksioneve që gjenerohen me më shumë se 50 për qind të vlerës së tyre drejtpërdrejt ose tërthorazi nga pasuria e paluajtshme që gjendet në Shtetin tjetër Kontraktues, mund të tatohen në atë shtet tjetër.
- (5) Fitimet nga tjetërsimi i çdo prone tjetër nga ato të përmendura në paragrafët 1, 2, 3 dhe 4 do të jenë të tatueshme vetëm në Shtetin Kontraktues, rezident i të cilit është tjetërsuesi.

#### **Neni 14**

#### **TË ARDHURAT NGA PUNËSIMI**

- (1) Me përjashtim të neneve 15, 17, 18 dhe 19 pagat, mëditjet dhe pagesa tjera të ngjashme që përfitohen nga një rezident i një Shteti Kontraktues nga punësimi i tij do të tatimohen vetëm në atë Shtet, përveç nëse puna ushtrohet në Shtetin tjetër Kontraktues. Nëse puna ushtrohet në këtë mënyrë, kjo pagesë që përfitohet atje mund të tatimohet në atë Shtetin tjetër.
- (2) Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 1, pagesat e përfituara nga një rezident i një shteti kontraktues, në lidhje me një punë të ushtruar në shtetin tjetër kontraktues, është i tatueshëm vetëm në shtetin e përmendur së pari, nëse:
- a) përfituesi është i pranishëm në shtetin tjetër për një periudhë që nuk i tejkalon në total 183 ditë, gjatë një viti përkatës fiskal; dhe
  - b) pagesa paguhet nga një punëdhënës ose në emër të një punëdhënësi, i cili nuk është rezident i shtetit tjetër; dhe
  - c) pagesa nuk mbulohet nga një njësi e përhershme, të cilën punëdhënësi ka në shtetin tjetër.
- (3) Pavarësisht nga dispozitat e mësipërme të këtij neni, pagesat e realizuara lidhur me punën e ushtruar në bordin e një anije ose aeroplani që operon në trafikun ndërkombëtar mund të tatimohen në Shtetin Kontraktues në të cilin ndodhet vendi i menaxhimit efektiv i ndërmarrjes.

#### **Neni 15**

#### **PAGESAT E DREJTORËVE TË BORDEVE TË KOMPANISË**

Pagesat e drejtorëve të bordeve të kompanisë dhe pagesa tjera të ngjashme që përfitohen nga një rezident i një shteti kontraktues në pozitën e tij si anëtar i bordit të kompanisë, dhe që është rezident i Shtetit tjetër kontraktues mund të tatimohen në atë Shtet tjetër.

## Neni 16

### ARTISTËT DHE SPORTISTËT

- (1) Pavarësisht nga dispozitat e nenit 7 dhe 14, të ardhurat që përfitohen nga një rezident i një shteti kontraktues si artist, aktor teatri, filmi, radioje ose televizioni, ose muzicent apo sportist, nga aktivitetet personale, të ushtruara në shtetin tjetër kontraktues, mund të tatimohen në atë shtet tjetër.
- (2) Kur krijohen të ardhura prej aktiviteteve personale, të ushtruara nga një artist ose sportist, në cilësinë e tij, nuk pranohen nga artisti ose sportisti, por nga person tjetër, ato të ardhura, pavarësisht dispozitave të neneve 7 dhe 14, mund të tatimohen në shtetin kontraktues në të cilin ushtrohen aktivitetet e artistit apo sportistit.
- (3) Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni, nuk vlejné për të ardhurat që artistë apo sportistë kanë krijuar përmes aktiviteteve personale në një shtet kontraktues, nëse qëndrimi i tyre në këtë shtet është i financuar pjesërisht apo plotësisht nga fonde publike, apo autoritete politike ose administrative të këtij shteti, ose nga institucione jofitimprurëse. Në këtë rast, të ardhurat do të tatimohen vetëm në Shtetin Kontraktues në të cilin artisti ose sportisti është rezident.

## Neni 17

### PENSIONET

Me përjashtim të paragrafit 2 të nenit 18, pensionet dhe pagesat tjera të ngjashme të paguara për një rezident të një Shteti Kontraktues për punën e tij të mëhershme, janë të tatueshme vetëm në atë Shtet.

## Neni 18

### SHËRBIMI QEVERTAR

- (1) a) Rrogat, pagat dhe pagesat tjera të ngjashme, që një Shtet Kontraktues ose autoritetet e tija politike apo administrative, ose persona juridik i paguajnë një individ, në lidhje me shërbimet e kryera për një Shtet Kontraktues ose autoritetet e tija politike apo administrative, ose persona juridik, janë të tatueshme vetëm në atë shtet.
  - b) Megjithatë, këto rroga, paga dhe shpërblime tjera të ngjashme janë të tatueshme vetëm në shtetin tjetër kontraktues, nëse shërbimet kryhen në atë shtet dhe nëse personi është rezident i atij shteti dhe, :
    - (i) që është shtetas i atij shteti; ose
    - (ii) që nuk është bërë rezident i atij shteti vetëm për qëllim të kryerjes së shërbimeve.

- (2) a) Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 1, pensionet dhe pagesat tjera të ngjashme të paguara nga, një shtet kontraktues ose nga një prej autoriteteve të tija politike apo administrative, apo personave juridik, apo prej fondeve investimesh të krijuara nga ky shtet kontraktues ose nga një prej autoriteteve të tija politike apo administrative, apo personave juridik, i paguajnë një individ, në lidhje me shërbimet e kryera për një Shtet Kontraktues ose autoritetet e tija politike apo administrative, ose persona juridik, duhet të taten vetëm në atë Shtet.
- b) Megjithatë, pensionet e tilla dhe pagesat e tjera të ngjashme mund të taten vetëm në Shtetin tjetër Kontraktues nëse personi është rezident dhe shtetas i atij Shteti.
- (3) Dispozitat e neneve 14, 15 dhe 16 zbatohen për rrogat, pagat, pensionet dhe shpërblime tjera të ngjashme në lidhje me shërbimet e kryera nga një shtet kontraktues, ose një prej autoriteteve të tija politike apo administrative, apo personave juridik.

### **Neni 19**

#### **STUDENTËT**

- (1) Një student, praktikant apo nxënës i cili qëndron në një Shtet Kontraktues vetëm për qëllime studimore ose shkollimi, dhe i cili në shtetin tjetër kontraktues është rezident apo ka qenë rezident pak para hyrjes në shtetin e përmendur në fillim, dhe i cili pranon pagesa që shërbejnë vetëm për akomodim, studim ose trajnim nuk mund të tatimohen në atë Shtet, përderisa të tilla pagesa realizohen prej burimeve jashtë atij Shteti.
- (2) Të ardhurat që një student ose praktikant, nxënësi cili është ose ishte më parë rezident i një Shteti Kontraktues pranon nga një punësim që ai ushtron në Shtetin tjetër Kontraktues për një periudhë që nuk tejkalon gjithsej 183 ditë në vitin fiskal përkatës, nuk duhet të taten në atë Shtet tjetër, nëse punësimi është i lidhur drejtpërdrejt me studimet ose praktikën e tij të kryer në shtetin e përmendur në fillim.

### **Neni 20**

#### **TË ARDHURA TË TJERA**

- (1) Të ardhurat, e një personi rezident tënjë Shteti Kontraktues, , që nuk janë trajtuar në nenet e mësipërme , janë të tatueshme vetëm në atë shtet, pa marrë parasysh prejardhjen e tyre.
- (2) Dispozitat e paragrafit 1, nuk zbatohen për të ardhurat siç janë të të ardhurat nga pasuria e paluajtshme, siç përcaktohet në paragrafin 2 të nenit 6, nëse pranuesi i këtyre të ardhurave është rezident në një Shtet Kontraktues dhe ushtron biznesin në shtetin tjetër kontraktues nëpërmjet një njësie të përhershme dhe të drejtat dhe asetet

financiare për të cilat paguhet të ardhurat i takojnë me të vërtetë kësaj njësie të përhershme. Në këtë rast, zbatohen dispozitat e nenit 7.

- (3) Të ardhurat që një rezident i një Shteti Kontraktues përfiton nga një Shtet tjetër Kontraktues si rezultat i kërkesës ligjore për mbajtje nuk mund të taten në Shtetin e parë të përmendur, nëse këto të ardhura do të përjashtoheshin nga tatimi sipas ligjeve të Shtetit tjetër Kontraktues.

## Neni 21

### SHMANGIA E TATIMIT TË DYFISHTË

Tatimi i dyfishtë do të eliminohet si vijon:

- (1) Në rastin e Austrisë:

- a) Kur një rezident i Austrisë realizon të ardhura të cilat, në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshje, mund të taten në Kosovë, atëherë Austria do të lejojë një zbritje nga tatimi mbi të ardhurat e atij rezidenti një shumë të barabartë me tatimin e paguar në Kosovë. Kjo zbritje, megjithatë, nuk do tejkalojë atë pjesë të tatimit të Austrisë, të llogaritur para se të bëhet zbritja, që i atribuohet të ardhurave që mund të taten në Kosovë.
- b) Kur një rezident i Austrisë ushtron një aktivitet të qëndrueshëm dhe aktiv në Kosovë, përfiton të ardhura që, në pajtim me dispozitat e nenit 7, mund të taten në Kosovë, Austria duhet pavarësisht nga nën-paragrafi a), të përjashtojë këto të ardhura nga tatimi.
- c) Të ardhurat e një personi rezident në Austri, të cilat përjashtohen nga marrëveshja për tu tatuar në Austri, megjithatë mund të përfshihen për tatim në Austri gjatë përcaktimit të tatimit në të ardhurat e mbetura të këtij rezidenti, marrë parasysh të ardhurat e përjashtuara.
- d) Dispozitat e nënparagrafit b) nuk do të zbatohen për të ardhurat e realizuara nga një rezident i Austrisë, nëse Kosova zbaton dispozitat e kësaj Marrëveshje për të përjashtuar ato të ardhurat nga tatimi ose zbaton dispozitat e paragrafit 2 të nenit 10 ose 11 ndaj këtyre të ardhurave.

- (2) Në rastin e Kosovës:

- a) Kur një rezident i Kosovës realizon të ardhura të cilat, në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshje, mund të taten në Austri, atëherë Kosova do të lejojë një zbritje nga tatimi mbi të ardhurat e atij rezidenti një shumë të barabartë me tatimin e paguar në Austri. Kjo zbritje, megjithatë, nuk do tejkalojë atë pjesë të tatimit të llogaritur para se të bëhet zbritja, që i atribuohet të ardhurave që mund të taten në Austri.

- b) Të ardhurat e një personi rezident në Kosovë, të cilat përjashtohen nga Marrëveshja për tu tatuar në Kosovë, megjithatë mund të përfshihen për tatim në Kosovë gjatë përcaktimit të tatimit në të ardhurat e mbetura të këtij rezidenti, marrë parasysh të ardhurat e përjashtuara.

## Neni 22

### TRAJTIMI I BARABARTË

- (1) Shtetasit e një shteti kontraktues nuk i nënshtrohen tatimit apo ndonjë kërkesë në lidhje me të në shtetin tjetër kontraktues, që është e ndryshme ose është më e rëndë sesa tatimi dhe kërkesat përkatëse, të cilave u nënshtrohen ose mund t'u nënshtrohen shtetasit e atij shteti tjetër në të njëjtat rrethana, veçanërisht në lidhje me rezidencën. Kjo dispozitë, pavarësisht nga dispozitat e nenit 1, gjithashtu zbatohet për personat që nuk janë banorë të njërit ose të të dy shteteve kontraktuese.
- (2) Personat pa shtetësi të cilët janë banorë të një shteti kontraktues nuk mund ti nënshtrohen në asnjë Shtet Kontraktues ndonjë tatimi ose ndonjë kërkesë lidhur me to, e cila është tjetër ose më e rëndë se tatimi dhe kërkesat përkatëse, të cilave u nënshtrohen ose mund t'u nënshtrohen shtetasit e Shtetit përkatës në të njëjtat rrethana, veçanërisht në lidhje me rezidencën.
- (3) Tatimi i ngarkuar për një njësi të përhershme që një ndërmarrje e një Shteti Kontraktues ka në Shtetin tjetër Kontraktues, nuk do të jetë më pak i favorshëm në Shtetin tjetër sesa tatimi i ngarkuar mbi ndërmarrjet e atij shteti tjetër që zhvillon të njëjtat aktivitete. Kjo dispozitë nuk do të interpretohet si detyrim i një shteti kontraktues për t'u dhënë banorëve të Shtetit tjetër Kontraktues lehtësime personale, lehtësime dhe zvogëlime për qëllime tatimore për shkak të statusit civil ose përgjegjësiive familjare që i jep banorëve të vet.
- (4) Përveç rasteve kur zbatohen dispozitat e paragrafit 1 të nenit 9, të paragrafit 6 të nenit 11 ose të paragrafit 4 të nenit 12, interesi, tantiemat dhe disbursime të tjera, të paguara nga një ndërmarrje e një shteti kontraktues ndaj një rezidenti të shtetit tjetër kontraktues, për qëllim të përcaktimit të fitimeve të tatueshme të kësaj ndërmarrjeje, do të jenë të zbritshme sipas të njëjtave kushte sikur t'i ishin paguar një rezidenti të shtetit të përmendur së pari.
- (5) Ndërmarrjet e një shteti kontraktues, kapitali i të cilave është në pronësi ose zotërohet tërësisht ose pjesërisht, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë nga një ose më shumë banorë të shtetit tjetër kontraktues, nuk i nënshtrohet asnjë tatimi ose kërkesë në lidhje me të në shtetin e përmendur së pari, që është e ndryshme ose më e rëndë se tatimi dhe kërkesat përkatëse, të cilave u nënshtrohen ose mund t'u nënshtrohen ndërmarrje të tjera të ngjashme të shtetit të përmendur së pari.
- (6) Dispozitat e këtij neni, pavarësisht nga dispozitat e nenit 2, zbatohen për tatimet e çdo lloji dhe përshkrimi.

### Neni 23

#### **PROCEDURA E MARRËVESHJES RECIPROKE**

- (1) Kur një person konsideron se veprimet e një ose të dy shteteve kontraktuese rezultojnë ose do të rezultojnë për të në tatim në mospajtim me dispozitat e kësaj marrëveshjeje, pavarësisht nga mënyrat e ankimit të parashikuara nga legjislacioni i brendshëm i atyre shteteve, ai pa u dëmtuar mund t'ia paraqesë çështjen e tij autoritetit kompetent të shtetit kontraktues në të cilin është rezident ose, nëse çështja e tij trajtohet në paragrafin 1 të nenit 22 të shtetit kontraktues në të cilin është shtetas. Çështja duhet të paraqitet brenda tre vjetësh nga njoftimi i parë i veprimit që rezulton në tatimin në mospajtim me dispozitat e marrëveshjes.
- (2) Autoriteti kompetent, nëse i duket se kundërshtimi është i bazuar dhe nëse nuk është vetë në gjendje për të arritur një zgjidhje të pranueshme, duhet të përpiqet të zgjidhë çështjen me anë të marrëveshjes reciproke me autoritetin kompetent të shtetit tjetër kontraktues, me qëllim shmangien e tatimit që nuk është në pajtim me këtë marrëveshje. Çdo marrëveshje e arritur zbatohet pavarësisht afateve kohore ose kufizimeve të tjera procedurale në ligjin e brendshëm të shteteve kontraktuese.
- (3) Autoritetet kompetente të shteteve kontraktuese përpiqen të zgjidhin me anë të marrëveshjes reciproke çdo vështirësi ose dyshim që lind në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj marrëveshjeje. Ata, gjithashtu, mund të konsultohen së bashku për shmangien e tatimit të dyfishtë, në rastet të cilat nuk janë parashikuar në marrëveshje.
- (4) Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese mund të komunikojnë me njëri-tjetrin në mënyrë të drejtpërdrejtë ose përmes një komisioni i cili përbëhet prej tyre ose përfaqësuesve të tyre, për qëllim të arritjes së një marrëveshjeje, në kuptimin e paragrafëve të mësipërm.
- (5) Nëse,
  - a) Në bazë të paragrafit 1, një person ka paraqitur një çështje tek autoriteti kompetent i shtetit kontraktues për shkak se veprimet e një ose të dy shteteve kontraktuese kanë rezultuar për atë person në tatim në kundërshtim me dispozitat e kësaj marrëveshjeje, dhe
  - b) Autoritetet kompetente nuk janë në gjendje të arrijnë një marrëveshje për të zgjidhur çështjen në pajtim me paragrafin 2, brenda dy vjetëve, nga paraqitja e çështjes tek autoriteti kompetent i shtetit tjetër kontraktues,

Çdo problem i pazgjidhur që rrjedh nga çështja, paraqitet në arbitrazh, nëse personi e kërkon këtë. Megjithatë, këto probleme të pazgjidhura nuk paraqiten në arbitrazh nëse për to është dhënë një vendim nga një gjykatë ose organ administrativ i një shteti. Përveç kur personi i interesuar drejtpërdrejt në çështje nuk e pranon marrëveshjen e ndërsjellë që zbaton vendimin e arbitrazhit, ai vendim është detyrues për të dyja shtetet kontraktuese dhe zbatohet pavarësisht afateve kohore në ligjet e brendshme të këtyre shteteve. Autoritetet kompetente

të shteteve kontraktuese, me marrëveshje reciproke, zgjidhin mënyrën e zbatimit të këtij paragrafi.

## Neni 24

### SHKËMBIMI I INFORMACIONIT

- (1) Autoritetet kompetente të shteteve kontraktuese shkëmbejnë atë informacion, që mendohet të jetë i nevojshëm për zbatimin e dispozitave të kësaj marrëveshjeje ose për administrimin, ose zbatimin e ligjeve të brendshme të shteteve kontraktuese, në lidhje me tatimet e çdo lloji dhe përshkrimin e caktuar në emër të shteteve kontraktuese, ose të nënndarjeve të tyre politike, ose autoriteteve lokale, në masën që tatimi sipas tyre nuk është në kundërshtim me këtë marrëveshje. Shkëmbimi i informacionit nuk kufizohet nga nenet 1 dhe 2.
- (2) Çdo informacion i marrë sipas paragrafit 1 nga një shtet kontraktues, trajtohet si i fshehtë në të njëjtën mënyrë si informacion i përfituar sipas ligjeve të brendshme të atij shteti dhe u deklarohet vetëm personave ose autoriteteve (duke përfshirë gjykatat dhe organet administrative), që merren me vlerësimin ose mbledhjen, zbatimin ose procedimin në lidhje me ose përcaktimin e ankimeve në lidhje me tatimet e përmendura në paragrafin 1, ose mbikëqyrjen e sa më sipër. Këta persona dhe këto autoritete e përdorin informacionin vetëm për këto qëllime. Ata mund ta deklarojnë informacionin në procedime gjyqësore me dyer të hapura ose në vendime gjyqësore. Edhe në një rast të tillë konfidencialiteti mbi të dhënat personale mund të thyhet vetëm nëse është e nevojshme ruajtja e interesave të një pale tjetër ose të interesave publike. Pavarësisht sa më sipër, informacioni i marrë nga një shtet kontraktues mund të përdoret për qëllime të tjera nëse ky informacion mund të përdoret për qëllime të tjera sipas ligjeve të të dyja shteteve dhe autoriteti kompetent i shtetit zbatues e autorizon këtë përdorim.
- (3) Në asnjë rast, dispozitat e paragrafit 1 dhe 2, nuk interpretohen sikur vendosin mbi një shtet kontraktues detyrimin,
  - a) për të realizuar masa administrative në mospajtim me ligjet dhe praktikën administrative të tij ose të shtetit tjetër kontraktues;
  - b) të japin informacion që nuk është i përfitueshëm sipas ligjeve ose në punën normale të administrimit në atë ose shtetin tjetër kontraktues;
  - c) të japin informacion që do të zbulonte çdo sekret tregtar, biznesi, industrial ose profesional, ose proces tregtar apo informacion, zbulimi i të cilit do të ishte në kundërshtim me politikën publike dhe në veçanti me mbrojtjen e të dhënave.
- (4) Nëse informacioni kërkohet nga një shtet kontraktues në pajtim me këtë nen, shteti tjetër kontraktues përdor masat e tij për mbledhjen e informacionit për të marrë informacionin e kërkuar, megjithëse atij shteti tjetër mund të mos i duhet ky informacion për qëllimet e tij tatimore. Detyrimi që gjendet në fjalinë e mësipërme i nënshtrohet kufizimeve të paragrafit 3, por në asnjë rast këto kufizime nuk

interpretohen sikur lejojnë një shtet kontraktues të refuzojë dhënien e informacionit thjesht pasi nuk ka interes të brendshëm për këtë informacion.

- (5) Në asnjë rast dispozitat e paragrafit 3 nuk interpretohen sikur lejojnë një shtet kontraktues të refuzojë dhënien e informacionit vetëm pasi informacioni mbahet nga një bankë, institucion tjetër financiar, i emëruar, ose person që vepron në një agjenci, ose cilësi mirëbesimi, ose pasi ka të bëjë me interesa pronësie të një personi.

## **Neni 25**

### **ANËTARËT E MISIONEVE DIPLOMATIKE DHE ZYRAVE KONSULLORE**

Asgjë në këtë marrëveshje nuk cenon privilegjet fiskale të anëtarëve të misioneve diplomatike ose zyrave konsullore sipas rregullave të përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare ose sipas dispozitave të marrëveshjeve të veçanta.

## **Neni 26**

### **PARANDALIMI I KEQPËRDORIMIT TË MARRËVESHJES**

Pavarësisht nga dispozitat e tjera të kësaj Marrëveshje, një përfitim sipas kësaj Marrëveshje nuk do të jepet në lidhje me një zë të të ardhurave nëse është e arsyeshme të konkludohet, duke pasur parasysh të gjitha faktet dhe rrethanat relevante, që marrja e atij përfitimi ishte një nga qëllimet kryesore të cilësdo marrëveshjeje ose transaksioni që ka rezultuar drejtpërdrejt ose tërthorazi në atë përfitim, përveç nëse vërtetohet se dhënia e këtij përfitimi në këto rrethana do të ishte në përputhje me objektin dhe qëllimin e dispozitave përkatëse të kësaj Marrëveshje.

## **Neni 27**

### **HYRJA NË FUQI**

- (1) Secili prej Shteteve Kontraktuese do të njoftojë tjetrin, për përfundimin e procedurave të kërkuara në legjislacionin e tyre për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e pranimit të njoftimit të fundit.
- (2) Dispozitat e kësaj Marrëveshje do të kenë efekt:
- a) në lidhje me të ardhurat e mbajtura në burim ose të ardhurat mbi to në ose pas datës 1 janar të vitit kalendarik menjëherë pas vitit në të cilin kjo marrëveshje hyn në fuqi, dhe
  - b) në lidhje tatimet, për tatimet e ngarkuara për çdo viti tatimor që fillon nga ose pas datës 1 janar të vitit kalendarik menjëherë pas vitit në të cilin kjo marrëveshje hyn në fuqi

**Neni 28**  
**NDËRPRERJA**

- (1) Kjo marrëveshje mbetet në fuqi deri sa të prishet nga një prej shteteve kontraktuese. Secili shtet kontraktues mund ta prishë këtë marrëveshje, nëpërmjet kanaleve diplomatike, duke bërë njoftim për prishjen të paktën gjashtë muaj para fundit të çdo viti kalendarik, që fillon pas skadimit të një periudhe pesëvjeçare nga data e hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje.
- (2) Në një rast të tillë, marrëveshja pushon së qeni në fuqi:
- a) në lidhje me tatimet e mbajtura në burim përkitazi me shumat e paguara ose të kredituara pas përfundimit të vitit kalendarik në të cilin është dhënë njoftimi i tillë, dhe
  - b) në lidhje me tatimet e tjera përkitazi me vitet e tatueshme që fillojnë pas përfundimit të vitit kalendarik në të cilin është dhënë njoftimi i tillë.

NË DËSHMI TË KËSAJ nënshkruesit, të autorizuar sipas rregullit, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.

BËRË në dy kopje në Vjenë, këtë ditë 8 qershor 2018, në gjuhën gjermane, shqipe dhe angleze, të gjitha tekstet janë njëjloj autentike. Në rast divergjencash në interpretim, do të mbizotëroj teksti në gjuhën angleze.

**Për Republikën e Austrisë:**

**Hartwig Löger**

**Për Republikën e Kosovës:**

**Bedri Hamza**

## PROTOKOLLI

Në momentin e nënshkrimit të Marrëveshjes për eliminimin e tatimit të dyfishtë në lidhje me tatimet mbi të ardhurat dhe parandalimin e evazionit fiskal dhe shmangies, të nënshkruar sot në mes të Republikës së Austrisë dhe Republikës së Kosovës, nënshkruesit janë pajtuar që dispozitat e mëposhtme do të përbëjnë një pjesë integrale të Marrëveshjes.

1. Referuar paragrafit 3 të nenit 5:

Është e kuptueshme që një vend ndërtimi, një projekt ndërtimi, montimi ose aktivitete mbikëqyrëse në lidhje me to sipas nënparagrafit a) nuk mund të përbëjnë një njësi të përhershme sipas nënparagrafit b).

2. Referuar paragrafit 2 të nenit 11:

Për sa kohë që në çdo Marrëveshje apo Konventë ndërmjet Kosovës dhe një shteti të tretë, tatimi mbi interesin që krijohet në Kosovë është i përjashtuar apo taten në një normë më të ulët, ky përjashtim ose normë më e ulët do të aplikohen automatikisht.

3. Referuar paragrafit 3 të nenit 16:

Kuptohet që paragrafi 3 zbatohet edhe për personat juridikë që zhvillojnë orkestra, teatro, grupe baleti, si dhe për anëtarët e subjekteve të tilla kulturore, nëse subjektet e tilla juridike janë në thelb subjekte jofitimprurëse në afat të gjatë dhe nëse kjo është e vërtetuar nga autoriteti kompetent i shtetit të banimit.

4. Referuar paragrafit 3 të nenit 20:

- a) Për qëllimet e paragrafit 3, pagesa e tillë përfshin gjithashtu pagesat për dëmet që rezultojnë nga krimet, vaksinat ose arsyet e ngjashme.
- b) Të ardhurat e përmendura në këtë paragraf nuk do të merren parasysh gjatë zbatimit të përjashtimit me metodën e progresit.

5. Referuar Nenit 24:

i. Autoriteti kompetent i shtetit kërkues do t'i japë këto informata autoritetit kompetent të shtetit të kërkuar kur bën një kërkesë për informacion sipas Marrëveshjes për të demonstruar relevancën e parashikueshme të informacionit në kërkesë:

- (a) identitetin e personit në shqyrtim ose hetim;
- (b) një deklaratë të informacionit të kërkuar duke përfshirë natyrën e tij dhe formën në të cilën shteti kërkues dëshiron të marrë informacionin nga shteti i kërkuar;
- (c) qëllimin tatimor për të cilin kërkohet informacioni;
- (d) arsyet për të besuar se informacioni i kërkuar është i mbajtur në shtetin e kërkuar ose është në posedim ose kontroll të një personi brenda juridiksionit të shtetit të kërkuar;
- (e) deri në masën e njohur, emrin dhe adresën e çdo personi që besohet të jetë në zotërim të informacionit të kërkuar;

(f) një deklaratë që shteti kërkues ka ndjekur të gjitha mjetet në dispozicion në territorin e vet për të marrë informacionin, përveç atyre që do të shkaktonin vështirësi disproporcionale.

ii. Kuptohet që shkëmbimi i informacionit të parashikuar në nenin 24 nuk përfshin masat që përbëjnë "ekspedita të peshkimit".

#### 6. Interpretimi i Marrëveshjes:

Kuptohet që dispozitat e Marrëveshjes të cilat janë hartuar sipas dispozitave përkatëse të Marrëveshjes Model të OECD-së për të Ardhurat në përgjithësi pritet të kenë të njëjtin kuptim siç shprehet në Komentarin e OECD-së. Të kuptuarit e fjalisë së mësipërme nuk do të zbatohet në lidhje me sa vijon:

- a) çdo rezervë ose vëzhgim të modelit të OECD-së ose komenteve të tij nga cilido Shtet Kontraktues;
- b) çdo interpretim të kundërt në këtë Protokoll;
- c) çdo interpretim të kundërt në një shpjegim të publikuar nga njëri prej Shteteve Kontraktuese që i është dhënë autoritetit kompetent të Shtetit tjetër Kontraktues përpara hyrjes në fuqi të Marrëveshjes;
- d) çdo interpretim të kundërt, i miratuar nga autoritetet kompetente pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes.

Komentari i OECD - siç mund të rishikohet herë pas here - përbën një mjet interpretimi në kuptim të Konventës së Vjenës të 23 majit 1969 mbi të Drejtën e Traktateve.

NË DËSHMI TË KËSAJ nënshkruesit, të autorizuar sipas rregullit, kanë nënshkruar këtë Protokoll.

BËRË në dy kopje në Vjenë, këtë ditë 8 qershor 2018, në gjuhën gjermane, shqipe dhe angleze, të gjitha tekstet janë njëloj autentike. Në rast divergjencash në interpretim, do të mbizotëroj teksti në gjuhën angleze.

**Për Republikën e Austrisë:**

**Hartwig Löger**

**Për Republikën e Kosovës:**

**Bedri Hamza**